

Statistikat e transportit*

Shkurt 2022

Tiranë, më 28 Mars 2022: Volumi i mallrave të ngarkuara/shkarkuara në porte, në muajin Shkurt 2022 është 357,9 mijë ton, duke u rritur me 4,1 %, krahasuar me Shkurt 2021.

Në dymujorin e vitit 2022, volumi i mallrave të ngarkuara/shkarkuara në porte është 644.7 mijë ton, duke u ulur me 9,2 %, krahasuar me dymujorin e vitit 2021.

Në muajin Shkurt 2022, volumi i mallrave të transportuara me hekurudhë është 1.649 mijë ton-kilometër, duke u ulur me 39,5 %, krahasuar me Shkurt 2021.

Në dymujorin e vitit 2022, volumi i mallrave të transportuar me hekurudhë është 3.375 mijë ton-kilometër, duke u ulur me 37,5 %, krahasuar me dymujorin e vitit 2021.

Tab. 1 Transporti i mallrave me det, hekurudhë dhe ajër

Periudha	Transporti i mallrave		
	Me det / ton	Hekurudhë 000/ton.km	Ajër / ton *
Shkurt 2021	343.912	2.725	123,9
Shkurt 2022	357.934	1.649	153,3
Ndryshimi vjetor (%)	4,1	-39,5	23,8
Janar-Shkurt 2021	709.603	5.397	272,7
Janar-Shkurt 2022	644.651	3.375	312,9
Ndryshimi vjetor (%)	-9,2	-37,5	14,7

* Përfshin mallrat dhe postën

Burimi: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ilogaritje të INSTAT

Në muajin Shkurt 2022, volumi i mallrave të transportuar me ajër është 153,3 ton, duke u rritur 23,8 % në krahasim me Shkurt 2021.

Në dymujorin e vitit 2022, volumi i mallrave të transportuar me ajër është 312,9 ton, duke u rritur me 14,7 %, krahasuar me dymujorin e vitit 2021.

Në Shkurt 2022, numri i fluturimeve të kryera është 1.816, duke u rritur 86,8 % në krahasim me muajin Shkurt 2021.

Për publikim 28/03/2022

Vijon

Tab. 2 Treguesit specifike të transportit ajror

Periudha	Numri i shoqërive ajrore*	Numri i fluturimeve	Numri i mbikalimeve
Shkurt 2021	11	972	3.559
Shkurt 2022	18	1.816	7.671
Ndryshimi vjetor (%)	63,6	86,8	115,5
Janar-Shkurt 2021	11	2.010	8.194
Janar-Shkurt 2022	18	4.058	16.701
Ndryshimi vjetor (%)	63,6	101,9	103,8

*Numri i kompanive ajrore i referohet numrit të kompanive të cilat janë licensuar të kryejnë fluturime në fillim të vitit

Burimi: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ilogaritje të INSTAT

Në Shkurt 2022, numri i pasagjerëve që udhëtojnë me linjë detare është 29.510 pasagjerë. Krahasuar me Shkurt 2021, ky tregues është rritur 13,4 %. Në dymujorin e vitit 2022, kanë udhëtuar me linjë detare 82.697 pasagjerë, duke u rritur me 32,9 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2021.

Në Shkurt 2022, numri i pasagjerëve që udhëtojnë me linjë hekurudhore është 759 pasagjerë. Krahasuar me Shkurt 2021, ky tregues është rritur me 2.2 herë. Në dymujorin e vitit 2022, kanë udhëtuar me linjë hekurudhore 1.385 pasagjerë, duke u rritur me 2.0 herë, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2021.

Në muajin Shkurt 2022, transporti ajror i pasagjerëve zë 87,7 % të transportit gjithsej.

Numri i pasagjerëve që kanë udhëtuar me linja ajrore, në Shkurt 2022 është 214.827 pasagjerë, duke u rritur me 3.0 herë, krahasuar me Shkurt 2021. Numri i pasagjerëve që kanë udhëtuar me linja ajrore, në dymujorin e vitit 2022 është 466.070 pasagjerë, duke u rritur me 2,9 herë, krahasuar me dymujorin e vitit 2021.

Tab.3 Transporti i pasagjerëve sipas mënyrës së udhëtimit

Periudha	Transporti i pasagjerëve		
	Me hekurudhë	Me det	Me ajër
Shkurt 2021	347	26.016	71.347
Shkurt 2022	759	29.510	214.827
Ndryshimi vjetor (%)	118,7	13,4	201,1
Janar-Shkurt 2021	692	62.248	158.578
Janar-Shkurt 2022	1.385	82.697	466.070
Ndryshimi vjetor (%)	100,1	32,9	193,9

Burimi: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ilogaritje të INSTAT

Eksportet/importet e mallrave sipas mënyrës së transportit

Në Shkurt 2022, vlera e mallrave të tregtuara (eksport dhe import) është 106,0 mld lekë ku 49,4 % e tyre u transportua me det.

Në dymujorin e vitit 2022, vlera e mallrave të tregtuara (eksport dhe import) është 196,0 mld lekë ku 50,3 % e tyre u transportua me det.

Eksportet e mallrave

Në Shkurt 2022, mallrat e eksportuara me det zënë 53,4 %, me tokë 34,5 % dhe me ajër 0,1 %. Mallrat e eksportuara me tokë në Shkurt 2022 janë rritur me 52,3 %, krahasuar me Shkurt 2021.


Tab.4 Eksporti i mallrave sipas mënyrave të transportit

Periudha	Eksport (mln lekë)				
	Me det	Me hekurudhë	Me tokë	Me ajër	Të tjera
Shkurt 2021	14.466	0	8.453	87	1.766
Shkurt 2022	19.922	0	12.875	45	4.448
Ndryshimi vjetor (%)	37,7	0,0	52,3	-47,9	151,9
Janar-Shkurt 2021	29.809	1	16.336	130	2.232
Janar-Shkurt 2022	38.489	0	24.251	104	9.452
Ndryshimi vjetor (%)	29,1	0,0	48,5	-19,4	323,5

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, llogaritje të INSTAT

Në dymujorin e vitit 2022, mallrat e eksportuara me det zënë 53,2 %, me tokë 33,5 % dhe me ajër 0,1%. Mallrat e eksportuara me tokë janë rritur 48,5 % krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2021.

Fig. 1 Struktura e eksporteve sipas mënyrës së transportit, Shkurt 2022



Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, llogaritje të INSTAT

Importet e mallrave

Në Shkurt 2022 mallrat e importuara me det zënë 47,3 %, me tokë 43,9 % dhe me ajër 2,6 %.

Mallrat e importuara me tokë në Shkurt 2022 janë rritur me 18,0 %, krahasuar me Shkurt 2021.

Tab.5 Importi i mallrave sipas mënyrave të transportit


Periudha	Import (mln lekë)				
	Me det	Me hekurudhë	Me tokë	Me ajër	Të tjera
Shkurt 2021	24.326	426	25.563	1.450	481
Shkurt 2022	32.472	109	30.153	1.788	4.175
Ndryshimi vjetor (%)	33,5	-74,4	18,0	23,3	768,0
Janar-Shkurt 2021	46.357	682	44.466	2.779	3.382
Janar-Shkurt 2022	60.189	220	52.989	3.402	6.913
Ndryshimi vjetor (%)	29,8	-67,8	19,2	22,4	104,4

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, Ilogaritje të INSTAT

Në dymujorin e vitit 2022, mallrat e importuara me det zënë 48,7 %, me tokë 42,8 % dhe me ajër 2,7 %.

Mallrat e importuara me tokë janë rritur me 19,2 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2021.

Fig. 2 Struktura e impoerteve sipas mënyrës së transportit, Shkurt 2022



Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, Ilogaritje të INSTAT

Për t'u konsultuar me botime të tjera, vizitoni faqen e INSTAT: <http://www.instat.gov.al/al/temat/industria-tregtia-dhe-sh%3%ABrbimet/transporti-dhe-aksidentet/>

Metodologjia

Publikimi i Statistikave të Transportit paraqet rezultatet mbi transportin e mallrave dhe pasagjerëve si dhe eksportin dhe importin e mallrave sipas mënyrës së transportit në frekuencë mujore. Të dhënat janë administrative. Burimi kryesor i informacionit është Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë si dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.

Përkufizime

Transport: Lëvizja e njerëzve dhe/ose mallrave duke përdorur mjete të ndryshme transporti. Transporti mund të kryhet me mjete të transportit tokësor, ajror dhe detar.

Transporti hekurudhor: Çdo lëvizje e mallrave dhe/ose pasagjerëve duke përdorur mjete me rrota të drejtuar mbi binarë.

Transporti tokësor: Çdo lëvizje e mallrave duke përdorur një mjet rrugor në një rrjet të caktuar rrugor.

Transport detar: Çdo lëvizje e mallrave dhe/ose pasagjerëve duke përdorur anije tregtare në udhëtime të cilat ndërmerren tërësisht ose pjesërisht me det.

Transport ajror: Çdo lëvizje e mallrave dhe/ose pasagjerëve duke përdorur avionë në udhëtime të cilat ndërmerren tërësisht ose pjesërisht me ajër.

Eksportet: Janë në përgjithësi mallra të destinuara tek një vend i tretë, të vendosura nën regjimin doganor, në përpunimin pasiv, ose të riekportuar pas përpunimit aktiv.

Vlera F.O.B: Është vlera e mallrave të eksportuara deri në kufirin e vendit eksportues dhe përfshin koston e mallrave të eksportuara dhe shpenzimet deri në kufi të vendit eksportues.

Importet: Janë në përgjithësi mallra që vinë nga një vend i tretë, të vendosura direkt në qarkullim të lirë ose që qëndrojnë në magazinat e ruajtjes nën procedurat doganore të lejimit për qarkullim të lirë, për përpunim aktiv ose për përpunim nën kontrollin doganor.

Vlera C.I.F: Është vlera e mallrave të importuara dërguar deri në kufirin e vendit importues, pra përfshin koston e mallit, edhe shpenzimet e transportit dhe sigurimit deri në kufirin e vendit që importon mallrat.

Nomenklatura e Statistikave të Transportit (NST 2007): Është një nomenklaturë statistikore e cila përdoret për mallrat e transportuara nëpërmjet katër mënyrave të transportit: rrugë, hekurudhë, rrugë ujore të brendshme dhe det.

Të dhënat e transportit detar, ajror dhe hekurudhor janë paraprake dhe subjekt rishikimi. Për më shumë, referohu: [Politika e Revizionimit Statistikor](#).

Shpjegimi i simboleve

0 vlerë më e vogël se gjysma e njësisë matëse

- pa vlerë

(...) mungesë të dhënash